



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2917/12 prot.

Datë 14.02.2024

V E N D I M
Nr. 178/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr.1266/2023, datë 05.12.2023, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK me NIPT L81904506I dhe adresë: Rruga dytësore “Maminas-Sukth”, km 2

Operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK me NIPT L51512008E dhe adresë rruga “Irfan Tomini” Pallati 59, kati 1, nr. 6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë me adresë: Rruga “Viktor Eftimiu”, Nr.12, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 30.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 111/2024 ku vendosi:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me vendimin e KPP-së nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 dhe brenda 5 ditëve të vërë në dijeni KPP për këtë fakt.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 454/1 prot., datë 08.02.2024 protokolluar me tonën nr.2917/9 prot., datë 12.02.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, dhe duke i bashkëngjitur shkresës edhe dokumentet e reja të procedurës që do të ripublikojë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 454/1 prot., datë 08.02.2024 protokolluar me tonën nr.2917/9 prot., datë 12.02.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, dhe duke i bashkëngjitur shkresës edhe dokumentet e reja të procedurës që do të ripublikojë.

II.2. Nga informacioni i shkresës së mësipërme si dhe nga verifikimet në (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit edhe në sistemin e prokurimit elektronik si dhe dokumentet e reja të procedurës që ka dërguar në KPP janë në përputhje me konstatimet e vendimit të KPP-së nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 KPP

II.3. Sa më sipër KPP konstaton se autoriteti kontraktor e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-

87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

